



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 1

Tiranë – E hënë, 14 janar 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 10458, datë 18.12.2018	Me objekt: Kërkesë për përfundimin e procedurave të falimentimit për subjektin: shoqëria tregtare “Dobrej” sh.p.k..... 3
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Qendër, nr. 188, datë 11.1.2019	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit: Durim Picari..... 6



VENDIM

Nr. 10458, datë 18.12.2018

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

Gjyqtar: ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretare gjyqësore Lusjana Fezollari, sot më datë 18.12.2018, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen civile me nr. 12616, Regj. Themeltar, që i përket:

KËRKUES: DREJTORIA RAJONALE E TATIMPAGUESVE TË MËDHENJ, TIRANË, e përfaqësuar në gjykim me autorizim përfaqësimi nr. 13728 prot., datë 26.10.2015 nga juristja znj. Gladiola Mita.

PERSONA TË TRETË: SHOQËRIA

“DOBREJ” sh.p.k., me seli në adresën: Rruga “Besim Imami”, nr. 50, Tiranë, me NIPT K61627018M, me përfaqësuese administratoren e falimentimit znj. Lindita Kikino.

OBJEKTI: Kërkesë për përfundimin e procedurave të falimentimit për subjektin: shoqëria tregtare “Dobrej” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar.

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, e ndodhur në zhvillimin të seancave gjyqësore të saj për fazën e dytë të procedurës së falimentimit,

VËREN:

Se, me kërkesën drejtuar gjykatës, pala kërkuuese, Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, ka kërkuar hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k.

Me vendimin nr. 362, datë 26.1.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur: *rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në prova dhe në ligj.*

Mbi ankimin e palës kërkuuese, Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 572, datë 28.10.2016, ka vendosur: *ndryshimin e vendimit nr. 362, datë 26.1.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe pranimin e kërkesës për çeljen e procedurës së falimentimit për Shoqërinë “Dobrej” sh.p.k.*

Pas këtij vendimi, dosja fizikisht është paraqitur nga sekretaria gjyqësore pranë trupit gjykues vetëm në datën 13.9.2018, duke kryer gjykata vetëm pas kësaj date veprimet e saj ligjore për fazën e dytë të kësaj procedure falimentimi.

Në lidhje me parashikimet ligjore në përputhje me rastin konkret, gjykata vëren se: neni 18/4, i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “*Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni vendos: c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit*”.

Neni 26, i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. *Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit. 2. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit përmban: a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personave juridikë; b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit; c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit, ç) të dhënat e parashikuara në nenin 27 dhe 29 të këtij ligji; d) urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës... 4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të falimentimit*”. Në përfundim, pas analizës së parashikimeve në ligj, Gjykata vëren se:

Sa më lart dhe në kushtet kur është vendosur për pranimin e kërkesës dhe hapja e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., me vendimin e saj të datës 14.9.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka disponuar me:

1. *Emërimin si administratore të falimentimit për shoqërinë “Dobrej” sh.p.k., të znj. Lindita Kikino, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 12, datë 16.10.2012, me adresë: “Rruga e Kavajës”, pallati 12-katësh, Shk. 3, Ap. 15, Tiranë.*

2. *Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.*

3. *Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.*

4. *Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratores së falimentimit, znj. Lindita Kikino.*



5. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

6. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

7. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

8. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i njoftohet administratores së falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., znj. Lindita Kikino.

9. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

16. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

17. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar: gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shekulli”.

18. U shpall në Tiranë, sot, më datë 14.9.2018.

Pas këtij vendimi ka rezultuar se nga ana e palës kërkuese, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, me shkresat nr. 9374/1 prot., datë 30.10.2018 dhe nr. 9374/prot., datë 18.12.2018 të saj, i është bërë me dije gjykatës se kërkesa për çeljen e procedurës së falimentimit të kësaj shoqërie ka qenë bërë për shkak të detyrimit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, neni 104, pika 1, germa “ç” (shfuqizuar) (ndryshuar me ligjin nr. 112/2016, datë 3.11.2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 219, datë 15.11.2016).

Nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë është konfirmuar se detyrimi tatimor që shoqëria “Dobrej” sh.p.k. ka ndaj DTM-së, është në vlerën e 32 lekëve.

Sa më sipër, kjo palë kërkuese e konsideron të panevojshme vazhdimin e procedurës së falimentimit dhe mbulimin e shpenzimeve gjyqësore të procedurës së falimentimit ndërkohë që ky subjekt nuk është debitor ndaj DTM-së.

Nga ana e administratores së falimentimit konfirmohet se shoqëria nuk ka asete dhe se kjo shoqëri nuk ekziston më, pasi nga viti 2007 nuk ushtron aktivitet tregtar.

Në frymën e ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, pasi në periudhën që DTM-ja ka bërë kërkesë për çeljen e procedurës së falimentimit, ligji i sipërcituar ka qenë në fuqi dhe, në referencë të neneve 13, 14, 33 të ligjit “Për falimentimin”, kusht për çeljen e procedurës së falimentimit është që subjekti të jetë i mbingarkuar me borxhe dhe të ketë asete ose masë për mbulimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit.

Në bazë të nenit 19, pika 1, e ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, DTM-ja nuk merr përsipër pagimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit në kushtet kur debitori rezulton të mos ketë asete dhe nuk është debitor ndaj Drejtorisë sonë.

Në këtë mënyrë kjo palë kërkoj mosvazhdimin e kësaj procedure, duke hequr dorë nga kjo e drejtë e saj për gjykimin e mëtejshëm të kësaj kërkesë.

Lidhur me këtë kërkesë të palës kërkuese, nga ana e saj administratorja e falimentimit e shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., znj. Lindita Kikino, u shpreh se ishte dakord me kërkesën pasi, siç e kishte shprehur dhe në fazën e parë të procedurës, kjo procedurë falimentimi nuk duhet



të ishte çelur si e tillë, por, për sa kohë që Gjykata e Apelit disponoj në këtë mënyrë është detyruar të vazhdoj. Më tej administratorja relatton se nuk është bërë asnjë thirrje mbledhesh kreditorësh, si për thirrje për raportim, ashtu dhe për verifikim, pasi nuk ka asnjë kreditor të evidentuar, me përjashtim të DTTM-së. Në përfundim të kësaj kërkesë kjo administratore shprehu se ishte dakord që kërkesa të pranohet, duke mos vazhduar më procedura.

Neni 5 i ligjit të kohës, nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, me ndryshimet përcakton se: *“Dispozitat e K. Pr. Civile dhe të ligjeve të tjera janë të zbatueshme edhe për procedurën e falimentimit për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji”*.

Neni 19 i ligjit të kohës nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, me ndryshimet përcakton se: *“Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit kur vërtetohet se pasuria e debitorit është e pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit, përveç kur kërkuesi parapaguan një shumë të mjaftueshme, sipas çmimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit”*.

Neni 33 i ligjit të kohës nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, me ndryshimet përcakton se: *“Procedura e falimentimit zbatohet mbi masën e falimentimit që përfshin të gjithë pasurinë dhe të drejtat e debitorit në datën e hapjes së procedurës së falimentimit dhe pasurinë që ai fiton gjatë zbatimit të kësaj procedure falimentimi”*.

Nisur nga i gjithë kuadri ligjor i sipërpërmendur dhe nga rrethanat e faktit të evidentuara qartësisht nga pala kërkuese dhe administratorja e falimentimit, gjykata vlerëson se kjo procedurë nuk duhet të vazhdojë dhe nuk duhet të hapet, pasi nuk ka pasur asnjë lloj shkak ligjor të përcaktuar nga ligji organik nr. 8901/2002. Vetë sjellja e palës kërkuese, duke pranuar faktin se kërkesa për çeljen e procedurës së falimentimit nuk është e lidhur aspak me shkaqet që kërkon ky ligj organik, nenet 13, 14 të tij, porse me një detyrim ligjor të përcaktuar nga një ligj i mëparshëm, ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, neni 104, pika 1, germa “ç” (shfuqizuar) (ndryshuar me ligjin nr. 112/2016, datë 3.11.2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 219, datë 15.11.2016), si dhe fakti se kjo shoqëri nuk rezulton aktualisht debitore ndaj palës kërkuese, shtuar dhe të gjitha argumentet e dhëna në vendimin e gjykatës, nr. 362, datë 26.1.2016, që ka rrëzuar kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit, janë arsye më se të mjaftueshme për gjykatën

për të vlerësuar rrëzimin e kësaj kërkesë për falimentimin e kësaj shoqërie.

Për sa më sipër gjykata çmon se bazuar në nenin 201/a, të K. Pr. Civile, *“Paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë krejtësisht ose pjesërisht nga e drejta e padisë. Në këtë rast, padia rrëzohet dhe paditësi nuk ka të drejtë ta ngrijë më këtë kërkesë-padi”*.

Nisur nga fakti se e drejta mbi disponimin e kërkesës i përket palës kërkuese, gjykata çmon se kjo kërkesë e saj është e ligjshme, objektivisht e justifikuar, e pranuar dhe nga administratorja e falimentimit dhe, si e tillë, duhet pranuar.

Në këto kushte, gjykata, e gjendur përpara këtij fakti referuar neneve 201/a, të K. Pr. Civile, neni 5, i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, me ndryshimet, çmon se kërkesa duhet rrëzuar për shkaqet dhe për bazën ligjore të sipërpërmendur.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenin 127, 201/a, të K. Pr. Civile,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës për falimentimin e shoqërisë “Dobrej” sh.p.k. për shkak të heqjes dorë nga kërkitimi nga ana e kreditorit të vetëm Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.

- Një kopje e vendimit t’i njoftohet administres së falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., znj. Lindita Kikino.

- Urdhërohet publikimi i vendimit për rrëzimin e kërkesës së falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Buletinin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

- Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit, Tiranë, brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

- U shpall sot më 18.12.2018, në Tiranë.

GJYQTAR
Ervin Pollozhani

**KËRKESË****Nr. 188, datë 11.1.2019****PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ
SUBJEKTIT DURIM PICARI**

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Qendër, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e Komisionit të Ankimit me nr. 1907, prot., datë 19.4.2017, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i ISHMPUT-së, duke u

konfirmuar nga shërbimi postar, adresë e panjohur.

Sa më sipër, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit të komisionit të ankimeve, respektivisht për subjektin si më poshtë:

Durim Picari**KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
INSPEKTORIATI SHTETËROR I MJEDISIT DHE PYJEVE

Nr. Prot. 1907Tiranë më 19.04 2017**VENDIM****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2 të nenit 51 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” të vendimit nr. 103, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve” të Këshillit të Ministrave dhe Ankimit për Vendimin përfundimtar me **Nr. 6, datë 13.02.2017, të ISHMP Qendër**, ndaj subjektit fizik/juridik “**Durim Picari**” protokolluar me nr. 861 prot datë 22.02.2017.

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 137 pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisionit i ankimit:

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit me gjobë me Nr. 6, datë 13.02.2017, të ISHMP Qendër, me ndryshim nga 1.000.000 Lekë në vlerën 500.000 Lekë të subjektit “Durim Picari” dhe rrëzimin e ankimit ndaj këtij vendimi administrativ përfundimtar.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë !

Ergys AGASI
KRYEINSPEKTOR

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019